



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:111584

Datë: 01.09.2022

Numri i dokumentit: 03381238

P. nr.306/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit D. H. nga Gjakova, për shkak të veprës Mashtrimit nga neni 323 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë, PP/II.nr.766/2021 të datës 18.06.2021, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datë **29.08.2022**, në prani të Prokurorit të shtetit Sadri Alija, përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit av. Nexhmedin Gashi, të dëmtuarit N. H., mbrojtësit të akuzuarit av. Gëzim Pozhegu dhe të akuzuarit D. H. me datën 31.08.2022, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **D. H.**, nga Gjakova, Rr. ". . .", data e lindjes . . ., i biri i I. dhe Z. e gjinisë D. , ka te kryer shkollën e mesme, taksist, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar -egjiptian , shtetas i R. Kosovës, i martuar- at 3 fëmijëve.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

-nga dhjetori i vitit 2018 e gjerë me dt.29.12.2020, me anë të paraqitjes së rreme apo duke i fshehur faktet, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vetën apo personin tjetër, dhe me qëllim shkaktim të dëmit material të pasurisë të personit tjetër, e mashtron duke e vë në lajthim të dëmtuarin N. H. nga fsh. . . K-Gjakovë, duke i thënë me rastin e takimit tek shtëpia e tij në Gjakovë, Rr. ". . .", se do ti sjellë fletposedimin për token e tij në fsh. . . , në atë mënyrë që për rregullimin e dokumenteve në Serbi, i ish-in dhënë kohë pas kohe nga i dëmtuari shuma prej 2900 euro përmes "Western Union" Prishtinë, nga data 01.12 gjerë me dt.29.12.2020 dhe para të tjera pjesë - pjesë në shumë të përgjithshme nga koha e dhënies e deri me dt.29.12.2020, totali prej 8000 euro, në atë mënyrë i pandehuri nuk i sjell dokumentet e premtuara e duke mos i kthyer as paratë e marra, e po ashtu, nga muaji shkurt i vitit 2021 i pandehuri e ndërpret edhe komunikimin me telefon me të dëmtuarin, me çka në këtë mënyrë me veprimet e tij të kundërligjshme përmes lajthimit dhe mashtrimit e ka nxit N. H.n të veprojë në dëm të pasurisë.

-me çka ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 323 prg.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39,43, 46, 47, 48, 49 ,69, 70, të KPRK-së, dhe nenit 323par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit D. H. i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej **12(dymbëdhjetë) muaj , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 2 (dy) viteve,** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale si dhe

DËNIM ME GJOBË , në shume prej **500 (pesëqind) euro** , të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 43 par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti iu zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **25 (njëzet e pesë) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë).**

I dëmtuari N. H., nga fsh. . . . Komuna Gjakova , për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30.00 €** si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30.00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë me aktakuzën PP/II.nr.766/2021 të datës 18.06.2021, e ka akuzuar të akuzuarin D. H. nga Gjakova , për shkak të veprës penale mashtrimit nga neni 323 . par..1 të KPRK-ës.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 15.02.2022 , përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë Prokurori Sadri Alija , lexoi aktakuzën PP.nr.766/21 të datës 18.06.2021 , me ç ‘rast deklaroi mbetet në tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari D. H. ,duke u deklaruar lidhur me fajësinë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Gëzim Pozhegu , deklaroi se nuk e pranon fajësinë për veprën me të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Me që i abuzuari nuk e ka pranuar fajësinë , gjykata gjatë shqyrtimeve gjyqësore me datat 15.02.2022 datë 07.03.2022,datë24.03.2022,datë26.04.2022 ,datë 11.05.2022, datë 23.06.2022dhedatë29.08.2022,,ka administruar provat materiale dhe personale të propozuara nga palët në procedurë dhe atë: të dëmtuarin N. H. në cilësi të dëshmitarit, dëshmitarin Ahmet Hoti si dhe leximin e provave materiale si raporti i oficerit R. M. me nr.të rastit 2020-EA-1599 të datës 1599,konfirmimi për dërgimin e të hollave përmes Western Union i datës 29.12.2020, Histori ati i lëshuar nga DKGJP në Gjakovë, nr.952 -06/20 i datës 29.10.2020 në gjuhën shqipe si dhe në gjuhën serbe me nr. 01-951-1-774/94 i dt. 11.11.1994, leximi i mesazheve të datës 26.12.2020 , në ora 01.42 dhe 01.44 min pas dite .

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 29.08.2022, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë Prokurori i shtetit Sadri Alija , lexoi aktakuzën PP/II.nr.766/2021 , deklaroi se nuk e

kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari, konsiderojmë se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 par. 1 te KPPK-ës, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat dhe shkresat që i bashkëngjiten aktakuzës. Në fjalën e përfundimtare deklaroi me vet pranimin e fajësisë u vërtetua në tërësi gjendja faktike se këtu i akuzuari D. H. nga dhjetori i vitit 2018 e gjere me dt. 29.12.2020 ,me anë të paraqitjes se rreme e mashtron duke e venë në lajthim të dëmtuarin N. H. duke i shkaktuar dëm në vlerë prej 8 mijë euro , ku me këto veprime ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 323 par. 1 te KPRK-ës, për çka i propozoi gjykatës të njëjti ta shpallë fajtor , ta dënojë sipas ligjit duke marr parasysh si rrethanë lehtësues pranimin e fajësisë në këtë shqyrtim gjyqësor , ndërsa si rrethanë rëndueses faktin se i njëjti është përsëritës i kësaj vepre penale si dhe i njëjti të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale, ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit i dëmtuari të udhëzohet në kontest civil.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 29.08.2022, mbrojtësi i të akuzuarit D. H. av. Gezim Pozhegu, deklaroi se edhe pse nga ana ynë është kërkuar shtyrje a këtij shqyrtimi gjyqësor me qëllim të sigurimit shtesë të dokumenteve në këtë rast siç është autorizimi i nënshkruar nga ana e palës së dëmtuar për kryerjen e veprimeve për të dëmtuarin ne R. Serbisë ,e njëjta nuk ka mund të sigurohet ,andaj me qe nuk kemi mund të sigurojmë provën nga R. e Serbisë , ne konsultim me të mbrojturin tim , i mbrojturi im është pajtuar që në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor të bëjë pranimin e fajësisë me që nuk ka prova tjera dhe këtë pasi i njëjti është njoftuar me favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë . Në fjalën e tij përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit , deklaroi se i mbrojturi im paraprakisht është konsultuar me mua lidhur me pranimin e fajësisë .Ne kemi ardhur në përfundim siç u deklarua edhe i mbrojturi im që të pranojë fajësinë ,dhe i njëjti para gjykatës ka pranuar fajësinë , ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit e me qenë se në shkresa të lendes nuk kemi ndonjë prove apo ekspertizë lidhur me këtë , i propozoi gjykatës lidhur me kompensimin e dëmit i dëmtuari të udhëzohet në kontest civil .

I akuzuar D. H. deklaroi se pas konsultimet te mjaftueshëm me mbrojtësin tim av. Gezim Pozhegu ne këtë fazë te shqyrtimit gjyqësor e pranojë ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehem dhe atë duke i ditur edhe me parë pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë. Në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare te mbrojtësit te tij.

Përf. i autorizuar i të dëmtuarit av Nexhmedin Gashi, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari, sa i përket ndjekjes penale i lë në vlerësim të gjykatës që të veprojë konform dispozitës ligjore por kërkojë kompensim dëmit të cekuar ne aktakuzë. Në fjalën përfundimtare deklaroi se siç rezultojë edhe nga deklarimi i prokurorit të shtetit edhe në fjalën përfundimtare i njëjti ngeli pranë aktakuzës që ishte objekt i gjykimit . Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe është zotuar se do e kompensojë demin , i propozoi gjykatës që konfrom nenit 463 par. 1 dhe 2 te KPPRK-ës ,që të vendos për kërkesën pasurore juridike për të dëmtuarin ,ashtu që ta detyrojë të akuzuarin që të kthejë shumen e përshkruar në aktakuzë.

I dëmtuari N. H. në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare te dhënë nga perf. i autorizuar av. Nexhmedin Gashi .

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale që i vihen në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza ,ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pambrojtjen e të akuzait administrimin e provave.

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si ë dispozitivt e këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të gjykohet në bazë të ligjit ,më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së , të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese gjykata e konsideron faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga neni 323. par.1 të KPRK-ës.dhe se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepër penale të natyrës së njëjtë sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të kësaj gjykate P.nr. 443/15 të datës 03.05.2016,, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është baba i tre fëmijëve ,sjelljen e tij korrekte ,i vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara, është penduar thellë për veprën penale . Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor , shprehjen e keq ardhjes nga i dëmtuari kërkim falja publike, të cilat rrethana ndikuan që gjykata ti zbatoj dispozitat e zbutjes se dënimit te parapara ne nenin 70 të KPRK-ës, gjykata te akuzuarit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë nga nenet 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin N. H. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, të kërkesës pasurore juridike .

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30.00 € , është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së, dhe shpenzimet në shumë prej nga 30.00 €, për Kompensimin e Viktimave të Krimin Nr.05/L-036 .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.306/21 më datë 31.08.2022**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në afatin prej **5 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.